



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Marrëdhënie partnerësh dhe fëmijët

Partneriteti

Të drejtat dhe detyrat e prindërve

Me qenë prind

Kujdestaria e fëmijëve

Tërheqja e familjes

Konfliktet

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Marrëdhënie partnerësh dhe fëmijët



Partneriteti

Në Zvicër janë të akceptuara forma të ndryshme të bashkëjetesës. Për me u martuar, duhet njeriu më s`paku të jetë 18 vjeç. Partnerët në martesë kanë të drejta të barabarta.

Bashkëjetesa

Format e bashkëjetesës janë ndryshuar në dhjetëvjetshin e kaluar shumë. Shpesh jetojnë çifte të pamartuar s`bashku (bashkëjetesë jashtë martesë, Konkubinat) dhe kanë po ashtu fëmijë të përbashkët. Një ndarje të roleve në mes partnerëve (burrë/grua) nuk ka. Edhe bashkëjetesa me gjininë e njëjtë është e akceptuar dhe me ligj e pranuar.

Martesa / partneriteti i regjistruar

Në Zvicër duhet njeriu të jetë 18 vjeç, për të guxuar të martohet. Kush don të martohet duhet të lajmërohet në komunën që banon në Zyrën e gjendjes Civile rajonale përkatëse për vendbanimin komunal, dhe duhet të bëhet kërkesa. Zyra e gjendjes civile e ndërmerr një procedurë për parapërgatitjen e martesës. Me këtë shikohet aftësia e partnerëve për martesë. Pas përmbylljes të parapërgatitjeve duhet të bëhet dasma mbrenda tre muajve. Zyra civile përkatëse informon saktësisht për procedurën dhe dokumentet e nevojshme. Nëse jeton njëri prej personave jashtë vendit, mundet të bëhet një kërkesë për ardhje për përgatitjen e martesës. Çiftet e gjinisë të njëjtë munden ta regjistrojnë partnerin e tyre deri më datë 30 qershor 2022, çka sjell me vete të drejta dhe detyrime të ngjashme me një bashkëshortësi. Nga 1 korriku 2022, mund të martohen edhe çiftet e së njëjtës gjini. Një bashkëshortësi e regjistruar që është lidhur më parë mund të shndërrohet në martesë.

Të drejtat dhe detyrimet

Partnerët në martesë sipas ligjit kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime dhe janë të barabartë. Të dy partnerët bashkëshortëror duhet të martohen me dëshirë. Nëse zyrtarët e kuptojnë, se dikush është detyruar të martohet (Zwangsheirat | Mariage forcé), munden këtë martesë ta shpallin të pavlefshme dhe atë i cili e ka detyruar këtë martesë ta dënojnë. Kush ndjehet se është detyruar për një martesë apo të qëndroj në martesë, duhet të kërkoj mbështetje. Njeriu mundet të kërkoj ndihmë në këshillimoren ndihmë për viktimë apo qendra profesionale, martesë e detyruar (0800 800 007).



Planifikimi familjar

Për pyetje për planifikimin familjar, shtatzënesinë dhe seksualitetin ka në kantonin e Bernit qendra speciale këshilluese në rajone të ndryshme. Këto vende informojnë falas dhe me besim për temat si mbrojtja, problemet seksuale, shtatzënesit e pa dëshiruara apo sëmundjet e organeve gjenitale. Ato këshillojnë edhe prindërit e ardhshëm dhe personat me fëmijë.

Shkurorëzimi

Shkurorëzimi (Scheidung | divorce) mundet s`bashku prej të dy bashkëshortëve apo edhe vetëm prej njërit bashkëshort të kërkohet. Përgjegjëse janë gjyqjet rajonale. Edhe bashkëshortësit të cilat janë bërë jashtë vendit munden sipas të drejtës Zvicerane të shkurorëzohen. Për këtë duhet njeriu që qëllimin për jetë ta ketë në Zvicër dhe më s`paku të ketë një vit me banim këtu. Një shkurorëzim mund të ketë ndikim te leja e qëndrimit, apo te procedura për nënshtetësi. Se a munden personat e huaj mbas shkurorëzimit të rrin në Zvicër, mvaret prej shumë faktorëve. Për viktimat e dhunës familjare vlejnë rregulla të posaçme. Informacione për shkurorëzim mundet njeriu me marr në këshillimore për familje dhe bashkëshortësi apo këshillimore për të drejta.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/partneriteti



Të drejat dhe detyrat e prindërve

Kush lind një fëmijë, duhet menjëherë ta lajmëroj lindjen në zyrën civile. Te çiftet e martuara është e drejta e përkatësis të fëmijut automatikisht e rregulluar, çiftet e pa martuara duhet për këtë vet të përkujdesen.

Lajmërimi i lindjes

Lindja e çdo fëmiju duhet të lajmërohet në zyrën civile rajonale kujdes: Se cila zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse mvaret prej vendit të lindjes dhe jo prej vendbanimit të prindërve. Nëse lindja bëhet në një spital, i dërgon spitali dokumentet në zyrën e gjendjes civile përgjegjëse. Nëse lindja nuk bëhet në një spital (por p.sh. në shtëpi), duhet që lindja të lajmërohet vet brenda tri ditësh. Zyra e gjendjes civile përgjegjëse informon, cilat dokumente janë të nevojshme. Fëmijët e lindur në Zvicër nuk marrin automatikisht nënshtetësin Zvicerane.

Njohja e atësis

Kur çiftet e martura kanë një fëmijë, bashkëshorti njihet automatikisht si baba. Nëse bashkëshorti dyshon që është baba, mundet me gjyq ta inicoj vërtetimin e atësisë. Kur prindërit nuk janë të martuar, babi i fëmijës nuk regjistrohet automatikisht si baba. Ai mundet fëmijën ta pranoj para ose pas lindjes në komunën që banon te zyra e gjendjes civile (Kindesanererkennung | Reconnaissance d'enfant). Nëse babi nuk e pranon fëmijën e tij mundet nëna me gjyq të kërkoj pranimin e fëmijut e tij.

Përkujdesja prindërore

Prindërit kanë të drejta dhe detyrime, për mirëqenjen e fëmijëve (elterliche Sorge | Autorité parentale). Këtu përkojnë për shembull edukimi, apo përkujdesja financiare. Prindërit përfaqësojnë fëmijët e tyre me ligj deri ata të bëhen 18 vjeç. Nëse prindërit janë të martuar i kanë automatikisht të drejtat dhe detyrimet e njëjta përkundrejt fëmijut. Nëse nuk janë të martuar duhet babai më parë ta pranoj fëmijun. Pastaj munden prindërit ta bëjnë vullnetarisht një sqarim me shkrim për përkujdesjen prindërore të përbashkët. Këtë e bënë njeriu ose s'bashku me pranimin e fëmijut te zyra e gjendjes civile rajonale apo më vonë te zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve (KESB|APEA) në gjyqin civil rajonal. Nëse prindërit e pa martuar nuk janë të një mendimi për të drejtën për përkujdesje ndaj fëmijut, vendosin zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve. Kush ka pyetje apo i nevojitet mbështetje, drejtohet në një qendër përkatëse për këshillim, këshillimore për edukim apo këshillimore për jetë bashkëshortore dhe familjare.



Përkujdesja materiale

Kur prindërit ndahen, janë ata edhe më tutje të detyruar, të përkujdesen për fëmijën (mbajtja, Unterhalt|Entretien). Ata duhet për këtë, ta rregullojnë gjendjen financiare, dhe përkujdesjen për fëmijë me njëri tjetrin. Pagesa për përkujdesje ndahet në mes babait dhe nënës. A, dhe sa njëri prind duhet të paguaj, mvaret prej situatës ekonomike dhe pjesëmarrjen e tij për përkujdesjen për fëmijun. Nëse nuk është e mundur një marrveshje, mundet njeriu të shkojë para gjyqit. Nëse vie të ndarja apo shkurorëzimi me gjyq, atëherë shuma që duhet të paguhet rregullohet me gjyq. Nëse nuk paguan partneri i detyruar për këtë, mundet njeriu në komunën ku banon të kërkojë ndihmë (Inkassohilfe|aide au recouvrement). Kjo ndihmon, që shumën e caktuar ta kërkojë nga i detyruari dhe/apo cakton një shumë për pagesë, nëse njëri nga partnerët ka të drejtë për këtë (Alimentenbevorschussung|Avance des contributions d`entretien).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/te-drejat-dhe-detyrat-e-p-rinderve



Me qenë prind

Me e edukuar një fëmijë, është me shumë përgjegjësi. Shumë prindër bëjnë aty këtu ndonjë pyetje, çka është e mirë për fëmijun e tyre. Shkëmbimi me prindërit e tjerë mund të jetë shumë i dobishëm. Përveç kësaj ka qendra të ndryshme për këshillim të cilat ndihmojnë.

Pikëtakimet

Ka oferta të shumta për nëna dha baba, që duan të shkëmbehen me prindërit e tjerë, apo që duan me fëmijën e tyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Disa oferta janë bërë posaçërisht, që prindërit zviceran dhe ata të huaj të ndërlidhin kontakte. Për fëmijët e vegjël ka shumë oferta, te të cilat edhe prindërit vin në kontakt me njëri tjetrin. Prindërit-fëmiju-edukatë fizike (MuKi-/VaKi-/EIKi- Turnen) ofron lojë, kënaqësi dhe lëvizje për prindër me fëmijë të vegjël. Edukata fizike ofrohet në shumicën e komunave.

Në qendrat familjare, ofrohen gjëra të ndryshme për prindër dhe fëmijët e tyre.

Në pikat e takimit të shërbimit falas për këshillimin e nënave dhe baballarëve mund të takoni prindër të tjerë, të krijoni kontakte dhe të përdorni dhomat për ushqyerjen me gji, matjen e peshës, leximin dhe lojërat. Bibliotekat kanë oferta për fëmijë të vegjël dhe të mëdhenjë si dhe për prindërit e tyre.

E vlen gjithsesi, që të njoftoheni te komuna që banoni mbi ofertat e ndryshme në rajon.

Arsimimi për prindër

Në kantonin e Bernit munden prindërit që të bëjnë kurse për tema të ndryshme. Ka kurse, që posaçërisht përmbushin nevojat e emigranteve dhe emigrantëve. Kështu ka p.sh., kurse për sistemin shkollor zviceran. Disa kurse ofrohen edhe në gjuhë të huaja. Për ofertat mund njeriu të informohet në portalin për familje të kantonit, si dhe në shkolla apo komunën e banimit. Edhe për temën e lindjes ka oferta të ndryshme për parapërgatitje.

Në seancat e këshillimit falas në grup të cilat ofrohen nga shërbimi i këshillimit të nënave dhe baballarëve, ju mund të shkëmbeni ide për çështje aktuale familjare, të merrni sugjerime të vlefshme nga ekspertët dhe të krijoni kontakte të reja në rajonin tuaj.



Këshillimi për edukim

Kush ka pyetje për edukim të fëmijëve, mundet të drejtohet në këshillimore të ndryshme. Në të gjitha rajonet ka këshillimore për edukim. Ato ofrojnë me detyrë nga kantoni këshillime falas për familje me fëmijë. Tutje ofrojnë këshillimoret për nëna dhe baba në komuna të ndryshme ndimë edhe për pytjet për foshnja. Te thirrjet urgjente të prindëve këshillojnë specialistët prindërit në telefon apo me E-Mail (telefoni 0848 35 45 55 (tarifa me telefon fiks), www.elternnotruf.ch).

Qendër këshillimi për nëna dhe baba

Shërbimi i këshillimit për nënat dhe baballarët ofron këshilla falas për të ushqyerit, kujdesin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve nga 0 deri në 5 vjeç. Këshilla ofrohet në një qendër këshillimi, nëpërmjet komunikimit me telefon ose në internet. Kontaktoni edhe nëse ju pengon mungesa e njohurive gjuhësore, ne do të gjejmë një zgjidhje! Informacion mbi këshillimin e nënave dhe baballarëve në 16 gjuhë
Informacion dhe regjistrim: 031 552 16 16

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/me-qene-prind



Kujdestaria e fëmijëve

Që me mund pas lindjes, nënat dhe babat përsëri të punojnë, kantoni i Bernit i mbështet ofertat për kujdestari të fëmijëve. Ka oferta të ndryshme, p.sh. çerdhet dhe kopshtet për fëmijë, prindër për përkujdesje ditore apo shkollë ditore. Shumica janë me para. Kush merr letra me vlerë për përkujdesje (betreungsgutscheine| bons de garde), duhet të paguaj më pak.

Qëndrim ditor për fëmijë

Në çerdhët për fëmijë (Kindertagesstätten |garderies) fëmijët kanë tërë ditën kujdestari. Shumica e ofertave janë për fëmijë 3 muajsh deri në moshën shkollë. Disa çerdhe për qëndrim ditor të fëmijëve ofrojnë kujdestari për fëmijë shkollor (para dhe pas shkollës edhe përgjatë drekës). Meqë listat e pritjes të shumtën janë të gjata, duhet prindërit fëmijën e tyre ta paraqesin shumë herët. Shpenzimet janë të ndryshme në çerdhet ditore të fëmijëve. Shumë komuna e paguajnë një pjesë të çmimit të përgjithshëm: Ata ju japin prindërve letra me vlerë për përkujdesje. Nevoja për këtë duhet të mund të vërtetohet. Vendet e qëndrimit ditor të fëmijëve apo komuna e banimit informojnë për mundësit e paraqitjes dhe shpenzimet.

Grupet për lojë

Shumë fëmijë vizitojnë para hyrjes në shkollë një grup për lojë (Spielgruppe|Groupe de jeu). Aty takohen fëmijët prej përfaqësimit 3 vjeç pa prindërit e tyre, për me luajt me krijuar etj. me kujdestare të shkolluara. Vizita në grupet e lojës është vullnetare. Për fëmijë që nuk flasin në shtëpi gjermanisht, është grupi për lojë një mundësi me ardhë në kontakt me gjuhën gjermane. Kjo e lehtëson hyrjen në shkollë. Shpenzimet janë të ndryshme dhe pjesërisht i bartë vendbanimi komunal. Grupe për lojë ka në shumë komuna, komuna banuese jep informacione të tjera.

Struktura ditore / dreka

Pjesërisht ofrojnë shkollat kujdestari jashtë mësimi. Kjo mvaret prej numrit të lajmërimeve. Në shkollat me strukturë ditore munden fëmijët shkollor p.sh. gjatë drekës të qëndrojnë në shkollë. Atyre ju ofrohet një drekë. Mas shkollës munden nën kujdestari t'i kryejnë detyrat e shtëpisë. Para fillimit të mësimi munden me ngrënë diçka, të luajnë apo lexojnë. Këto oferta duhet të paguhet nga prindërit. Tarifat janë shpesh të mvarura nga të ardhurat e prindërve. Fëmiju mund të përfitoj nga kjo ofertë një apo më shumë ditë.



Familjet ditore

Familjet ditore (Tagesfamilien) janë familje, që fëmijët përgjatë një kohe të caktuar ditore (të shumtën tërë ditën) t'i marrin pranë vetes. Kjo ofertë për kujdestari të fëmijëve është te prindërit në marrëdhënie pune shumë e kërkuar. Ka vende ndërmjetësuese, që gjatë kërimit të një familje ditore ndihmojnë dhe informojnë mbi tarifat.

Kujdestare për foshnje / Situatat emergjente

Në Zvicër angazhohen shpesh të rinjtë si kujdestarë të foshnjave në mbrëmje apo në fundjavë. Kryqi i kuq Zviceran (SRK|CRS) Bern posedon një listë me vende ndërmjetësuese për kujdestar për foshnja, të cilët e kanë bërë një kurs. Është e natyrshme që të rinjtë të paguhen. Në raste të paparashikuara emergjente ofron Kryqi i kuq Zviceran (SRK|CRS) Bern përkujdesje për fëmijë. Shembull kur njëri prind duhet të shkojë në spital dhe askush tjetër nuk mund të përkujdeset për fëmijun. Kujdestaria kushton, disa sigurime shëndetësore i mbulojnë shpenzimet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/kujdestaria-e-femijeve



Tërheqja e familjes

Anëtarët e familjes të personave, të cilët jetojnë në Zvicër, mundën sipas rrethanave të vijnë në Zvicër. Kur të afërmit dhe të njofshmit dëshirojnë të vijnë në Zvicër, duhet të aplikojnë sipas vendit që vijnë për një vizë vizite.

Prurja e familjes

Parimisht ekziston mundësia, që edhe antarët familjar (të afërmit direkt apo partneri bashkëshortor) prej personit që jeton këtu të vijnë në Zvicër (prurja e familjes, Familiennachzug | Regroupement familial). Për cilët antarë të familjes mund të aplikohet, mvaret prej përkatsisë shtetërore dhe leje qëndrimit të aplikuesit për kërkesë. Edhe personat me një qëndrim kalimtar (letërnjoftim F) mundën sipas rrethanave ta tërheqin familjen e tyre. Është e këshillueshme, që të bisedohet për parakushtet me një person profesionist. Informacione ju ofron zyra për shërbim të popullit (ABEV | OPOP), komuna apo zyrat për integrim. Kërkesat për prurjen e familjes duhet të bëhet te shërbimi kantonal për migrim. Banorët e qyteteve të Bernit, Biel dhe Thun duhet ta bëjnë kërkesën në zyrën e autortiteve të qytetit për banorë. Kujdes: Kërkesa për prurje të familjes duhet të bëhet mbrenda një kohe të caktuar. (Sipas rregullit brenda 1-deri 5 vjet nga data e hyrjes në Zvicër). Procedura te fëmijët është më e shkurtër se te personat e rritur (p.sh. partneri i bashkëshortësisë).

Parapërgatitja për martesë

Kush banon në Zvicër dhe dëshiron ta martoj një partnere apo partner që vie nga jashtë, mundet për parapërgatitje të martesës ta bëjë një kërkesë për ardhje (Vorbereitung der Heirat). Kjo leje ju mundëson partnerës apo partnerit, që para martesës të vijnë në Zvicër dhe të martohen këtu. Zyra për Migrim dhe Integrim e kantonit (Amt für Migration und Integration) vendos për kërkesën dhe njofton për dokumentet e nevojshme dhe ecurin e saktë të procedurës.

Viza e udhëtimit

Për banoret dhe banorët e shumë vendeve nuk është e thjeshtë, që ta marrin një vizë udhëtimi për në Zvicër, shembull për të vizituar të afërmit. Mundet me qenë, që prej personave që jetojnë këtu të kërkohet të bëjnë një ftesë me shkrim dhe një garantim financiar të detyruar (Verpflichtungserklärung | Déclaration de prise en charge). Përfaqësit Zvicerane jashtë vendit vendosin për kërkesën dhe njofton për dokumentet e nevojshme dhe ecurin e saktë të procedurës. Informacionet mund të merren edhe te zyra kantonale për shërbim të popullit (ABEV | OPOP).



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/terheqja-e-familjes

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Marrëdhënie partnerësh dhe fëmijët



Konfliktet

Te konfliktet në partneritet apo familje ndihmojnë qendra të ndryshme këshilluese. Dhuna në familje apo bashkëshortësi është e ndaluar.

Konfliktet në marrdhënie të partnerëve

Kur te partnerët vie deri te konfliktet, munden partnerët të marrin ndihmë profesionale (Eheberatung | consultation conjugale). Këshillimoret speciale ju ndihmojnë ju, të gjeni zgjidhje. Bisedat e para janë zakonisht falas apo më lirë. Në çdo rajon ka për këtë një këshillimore përgjegjëse.

Konfliktet në familje

Në familjet me fëmijë mundet nganjëherë me ardhë në situata të vështira, të cilat për prindër e fëmijë munden me qenë të besdizshme. Në çdo rast është e këshillueshme, që prindërit të kërkojnë ndihmë, kur nuk din më si t'ia bëjnë tutje. Te këshillimoret për familje (Familienberatungsstelle | service de consultation familiale) mundet njeriu personalisht të këshillohet. Në thirrjen emergjente për prindër (Elternnotruf) këshillojnë njerëzit specialist në telefon apo me e-mail, gjatë pyetjeve për edukim apo kur keni brenga për fëmijun tuaj (telefoni 0848 35 45 55 (tarifa me telefon të shtëpisë www.elternnotruf.ch). Fëmijët dhe të rinjtë munden përmes telefonit, e-mail, sms apo chat në thirrjen emergjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (falas), www.147.ch).

Dhuna shtëpiake

Dhuna në familje është një delikt zyrtar. Kush ushtron dhunë, e bënë veten të dënueshëm- pavarësisht nga pesha e dhunës. Nuk ka rëndësi, a ushtrohet dhunë kundrejt partnerës, partnerit në martesë, apo në fëmijë. Zyrtarët duhet të bëhen aktiv, kur kuptojnë për dhunë në familje. Për viktimat të dhunës ka oferta me besim mbështetëse falas. Në banime speciale (Frauenhaus / Väterhaus | Maison d'accueil) munden gratë apo burrat s' bashku me fëmijët e tyre përkohësisht të kërkojnë mbrojtje. Në tri shtëpitë e grave (rajoni Bern, Biel dhe Thun) mundet njeriu përgjatë 24 orëve të telefonoj (lidhja e hapur AppElle! 031 533 03 03). Këshilltarët ju ndihmojnë në raste të vështira me besim dhe falas. Ato ju ofrojnë mbrojtje dhe vend për banim. Fëmijët dhe të rinjtë munden në thirrje emergjente për fëmijë (Kindernotruf) të thërrasin (telefoni 147 (falas), www.147.ch). Kush ndihet i kërcënuar nga një antarë i familjes, duhet ta thërras policinë (telefoni 117). Këta munden që një person, që ushtron dhunë apo kërcënohet të ushtroj dhunë, për një kohë të gjatë ta largoj prej banese apo shtëpie.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/konfliktet

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Marrëdhënie partnerësh dhe fëmijët